



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BULETINI STATISTIKOR

JANAR - PRILL, 2024

Tabela e Lëndës

1	Treguesit kryesorë të veprimitarisë audituese
2	Mesazhet në Auditimet e Performancës
3	Niveli i Pranueshmërisë së Rekomandimeve
4	Zhvillimi dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
5	Programi i Transparencës dhe e Drejta për Informim
6	Auditime në media
7	Anekse

AKRONIME

ISSAI - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

EUROSAI - Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit

GAO - Zyra e Përgjegjshmërisë Qeveritare, SHBA

ECA - Gjykata Evropiane e Audituesve


CEF - Qendra e Ekselencës në Ekonomi e Lubjanës

SAI - Institucione Supreme të Auditimit

TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

TI - Teknologjia e Informacionit

AKTIVITETI I KLSH PËRMES SHIFRAVE




* Në 2 auditime nuk janë dhënë opinione mbi pasqyrat financiare

1. TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË AUDITUESE

1.1 Auditimet sipas llojit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar-prill 2024, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 210, datë 18.12.2023, të Kryetarit të KLSH, duke kryer dhe evaduar 19 misione auditimi, në vlerësim të përputhshmërisë, rregullshmërisë financiare, performancës dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme. Detajuar sipas llojit të auditimit, aktiviteti auditues paraqitet në tabelën në vijim:

Infografik nr. 1: Misionet e auditimit të evaduara, në numër dhe përqindje ndaj totalit



1.2 Institucionet ku janë kryer auditimet

Në periudhën janar - prill 2024, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit në **29*** subjekte, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Infografik nr. 2: Kategoritë e institucioneve të audituara, në numër



*Në disa auditime të performancës, mund të përfshihen edhe subjekte në të cilat janë kryer edhe auditime financiar dhe/ose auditim përputhshmërie.

1.3 Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor 2024, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën janar – prill 2024, ka përfunduar kryerjen e 19 auditimeve, duke dhënë:

- 24 opinione për 15 auditime financiare & përputhshmërie, nga të cilat: 3 financiare, 1 përputhshmërie dhe 11 te kombinuar (financiar & përputhshmërie);
- 1 mesazh auditimi për 1 auditim performance;
- 3 konkluzione në auditimet e përputhshmërisë për çështje të veçanta.

Infografik nr. 3: Opinionet/mesazhet/konkluzionet



Opinionet, mesazhet dhe konkluzionet e auditimit, të ndara sipas llojit të auditimit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1: Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera		Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzione	Mesazhe	
Financiar	1	2	-	-	3
Të kombinuar nga të cilët:					
<i>Financiar</i>	6	3	-	-	9
<i>Përputhshmërie</i>	10	1	-	-	11
IT	-	-	-	-	-
Përputhshmërie	1	-	-	-	1
Performance	-	-	-	1	1
Përputhshmërie (për çështje te vecanta)	-	-	3	-	3
Total	18	6	3	1	28

Mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 100), në baze të gjetjeve të konkluduara mbi evidencat e auditimit, materialitetit dhe përhapjes, opinioni i dhënë mund të jetë “i modifikuar” ose “i pamodifikuar”. Në vijim:


Opinionet e pamodifikuar mund të jenë:

- të pakualifikuar, ose
- të pakualifikuar me theksim çështje


Opinionet e modifikuar mund të jenë:

- të kualifikuar,
- të kundërt, ose
- refuzues

Infografik nr. 4: Ndarja e opinionëve, mesazheve dhe konkluzioneve sipas llojit



1.4 Rekomandimet sipas natyrës



1.4.1 Përmirësime ligjore & Masa organizative

Gjatë periudhës janar-prill 2024, për 19 auditimet e përfunduara, KLSH ka adresuar rekomandime për 344 masa organizative dhe 3 propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore, në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës, të paraqitura më hollësisht në tabelën në vijim:


Tabela nr.2: Përmirësime ligjore dhe masa organizative

Grupet e institucioneve	Nr. auditimesh	Masa organizative	Përmirësime ligjore
Institucione të pavarura, të qeverisjes qendrore dhe të varësisë	6	60	3
Institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	11	273	-
Institucione në të cilat janë kryer auditimet e performancës	1	11	-
Shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj	1	-	-
Total	19	344	3

Rekomandimet për përmirësime ligjore janë dhënë në fushën e prokurimit publik sa i takon nevojës për harmonizimin e kuadrit ligjor lidhur me:

- afatet e ankimit administrativ në prokurimet publike të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë; si dhe
- me rregullimin e procedurave dhe dokumentacionit të ankandëve publike.


Infografik nr. 5: Rekomandimet për përmirësime ligjore



1.4.2 Gjetje me efekte negative në të ardhura dhe shpenzime

Gjatë periudhës janar-prill 2024, janë dhënë 134 rekomandime mbi gjetje me efekte negative në buxhetin e shtetit, për total vlerën 2,107,937 mijë lekë, nga të cilat: dëmi ekonomik vlerësuar 20,790 mijë lekë, menaxhimi jo efektiv i fondeve në vlerën 2,000,168 mijë lekë dhe 86,979 mijë lekë në mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor

Infografik nr. 6: Efektet negative financiare ne buxhet sipas fushave kryesore (ne '000 lekë)




Vlera e efekteve financiare me pasojë dëm ekonomik* në buxhetin e shtetit, është konstatuar në fushën e shpenzimeve, në zërin “Shpenzime në procedura prokurimi dhe zbatim punimesh” në shumën 20,697 mijë lekë, sa i takon shkeljeve në: përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vlerësimit, likuidimit të faturave për zërat e punimeve të pa kryera etj, ku peshën më të madhe e zënë subjektet si: Bashkia Fier në vlerën 5,243 mijë lekë; Bashkia Shkodër në vlerën 3,662 mijë lekë; dhe Bashkia Lezhë në vlerën 1,662 mijë lekë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë periudhës janar – prill 2024, ka evidentuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ* në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike në vlerën totale 2,000,168 mijë lekë nga të cilat:

- 1,854,214 mijë lekë në fushën e të ardhurave (ose rreth 93% e totalit) kryesisht ne te ardhurat e qeverisjes lokale për çështje që lidhen me detyrime për taksat dhe tarifat vendore, mos tarifimit/përlllogaritjes së gabuar/mos aplikim të kamat vonesave për përdorimin e pronave të bashkisë nga subjektet private; detyrimeve të pashlyera për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë etj; dhe
- 145,954 mijë lekë në fushën e shpenzimeve (ose rreth 7% e totalit), si rezultat i shkeljeve të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keq menaxhimin e fondeve të programuara apo mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit jo në përputhje me kuadrin ligjor.

*Vlera e detajuar e dëmit ekonomik, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.4,

**Vlera e detajuar e menaxhimit jo efektiv sipas subjekteve, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.5



KLSH, për periudhën janar – prill 2024, ka konstatuar **mangësi në aktivitetin kontrollues doganor** me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave doganore, si detyrime dhe penalitete të vlerësuara në vlerën 86,979 mijë lekë, konstatuar në Degën Doganore Kakavijë, si pasojë e mos arkëtimit të detyrimeve doganore; diferencave prej mos hartimit të deklaratave doganore konform faturës së dorëzuar nga operatori; pagesa detyrimesh doganore në import për të cilat nuk është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor, etj.

***Vlera e detajuar efekteve negative të konstatuara në fushën e tatimeve dhe doganave, gjendet e pasqyruar në Aneksin nr. 4.6*

Tabela në vijim paraqet vlerën e dëmit ekonomik dhe atë të menaxhimit jo efektiv të fondeve, të organizuar sipas fushave ku është konstatuar parregullsia:

Tabela nr 3: Efektet financiare negative sipas fushave (në '000 lekë)


Efekte negative financiare	Dëm ekonomik	Menaxhim jo efektiv	Ndikim negativ tatime/dogana (aktiviteti kontrollues)	Total
Shpenzime	20,697	145,954	-	166,650
Procedura prokurimi	-	64,328	-	64,328
Shpenzime operative	-	39,833	-	39,833
Shpenzime për paga & sig. shoqërore	-	1,360	-	1,360
Shpenzime të tjera	-	40,433	-	40,433
Zbatim punimesh	20,697	-	-	20,697
Të ardhura	94	2,000,168	86,979	1,941,286
Mangësi në aktivitetin kontrollues doganor	-	-	86,979	86,979
Të ardhura në urbanistikë	-	153,243	-	153,243
Të ardhura nga aktiviteti doganor	94	-	-	94
Të ardhura nga qerate/shitje/blerje	-	67,428	-	67,428
Të ardhura të tjera	-	37,826	-	37,826
Shkelje e legjisllacionit tatimor në qeverisjen lokale	-	1,595,716	-	1,595,716
Total	20,790	2,000,168	86,979	2,107,937

1.5 Masa disiplinore dhe administrative

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 208 rekomandime për masa administrative dhe disiplinore, nga të cilat 184 masa disiplinore dhe 24 masa administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodit të Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 169 masave disiplinore (pasi për 15 masa të tjera, punonjësit kanë rezultuar të larguar nga puna).


Infografik nr. 7: Masat disiplinore sipas ligjit për nëpunësin civil dhe sipas kodit të punës




Bazuar në Ligjin Nr.154, atë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara, ka adresuar tek subjektet e audituara 24 masa administrative.

Konkretisht, për shkeljet e konstatuara, KLSH u ka kërkuar organeve respektive (APP, IMTV, Inspektoratit Ndërtimor, Urbanistik dhe Ministrisë së Linjës) shqyrtimin dhe marrjen e 24 masave administrative, si në infografikun më poshtë:

Infografik nr. 8: Masat administrative



2. MESAZHET NË AUDITIMET E PERFORMANCËS



BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive duhet të intensifikojë bashkëpunimin me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të identifikuar nevojat e grave rurale, si dhe më pas të hartojë programe të nxitjes së punësimit, në vlerësim të potencialit dhe aftësive të tyre në fusha të ndryshme, si bujqësia, shërbimet sociale, arsimi, teknologjia, etj.


Nxitja e programeve të punësimit në vlerën e diversitetit dhe kontributit të çdo anëtari të komunitetit në ndërtimin e një shoqërie të fortë dhe të qëndrueshme të hartuara dhe të zbatuara nga për vitet 2020-2023, për gratë janë të përgjithshme dhe nuk japin plotësisht, panoramën e gjithë rajoneve dhe referuar vlerësimit të nevojave. Infrastruktura vendore nuk nxit përfshirjen e grave rurale në tregun e punës, pasi në zonat rurale mungojnë çerdhet, ndërsa shërbimi i kopshteve nuk ofrohet në të gjitha njësitë administrative rurale si dhe mungon transporti publik nga njësia qendër drejt të gjitha njësive administrative të bashkive.

3. NIVELI I PRANUESHMËRISË SË REKOMANDIMEVE*

Gjatë periudhës janar-prill 2024, Kontrolli i i Lartë i Shtetit ka rekomanduar 481* masa, nga të cilat: 344 janë masa organizative, 3 masa për ndryshime apo përmirësime ligjore, 37 masa shpërblim dëmi, 92 masa me efekte negative për shkak të parregullsive dhe 5 masa si pasojë e mangësive të konstatuara në aktivitetin kontrollues tatimor & doganor, me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore.

Nga 481 masa, kanë përmbushur afatin ligjor** prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes mbi pranueshmërinë e rekomandimeve, 374 masa të cilat janë pranuar plotësisht***.

Infografik nr. 8: Pranueshmëria e masava sipas llojit



* Pa përfshirë masat disiplinore dhe administrative pasi statusi i tyre do të shikohet përgjatë zbatimit të rekomandimeve

* sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

** Për subjektet që nuk kanë sjellë përgjigje brenda 20 ditëve sipas nenit 15, shkronja j të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", automatikisht statusi i rekomandimeve konsiderohet "i pranuar".

*** 80 masa organizative nuk kishin përmbushur afatin e kthimit të përgjigjes në datën e raportimit të këtij buletini; 9 masa shpërblim dëmi nuk kishin përmbushur afatin e kthimit të përgjigjes në datën e raportimit të këtij buletini; 18 masa me efekte negative për shkak të parregullsive nuk kishin përmbushur afatin e kthimit të përgjigjes në datën e raportimit të këtij buletini.

Në total, 107 masa nuk kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes. Për këto masa, KLSH do të raportojë në Buletinin e rradhës.

Nga 481 masa në total, kanë përmbushur afatin ligjor 20 ditor të kthimit të përgjigjes, 374 masa ndërsa 107 prej tyre nuk e kanë plotësuar ende këtë afat. Nga 374 masat të cilat kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes, janë pranuar 374, ose 100%.

Konkretisht:

- nga 344 masa organizative, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 264, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%;
- nga 3 masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 3 masa, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%;
- nga 37 masa shpërblim dëmi, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 28 prej tyre, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%;
- nga 92 masa 3-E, efekte negative për shkak të parregullsive, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 74 prej tyre, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%;
- nga 5 masa mangësi në aktivitetin kontrollues tatimore me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore dhe doganore, kanë përmbushur afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes 74 prej tyre, të cilat janë pranuar plotësisht ose 100%.

5. ZHVILLIMI & MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

5.1 Struktura dhe Organika

Gjatë periudhës Janar-Prill 2024, KLSH ka vijuar të adresojë menaxhimin e burimeve njerëzore në linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore dhe në funksion të realizimit të mbulimit me auditim sipas detyrimeve ligjore.


Në fund të periudhës raportuese, numri faktik i punonjësve është 217 punonjës, nga të cilët 160 janë staf auditues (ose 73.7% e numrit total të punonjësve) të përbërë nga:

- 13 kryeauditues
- 32 auditues të lartë
- 83 auditues të parë
- 32 auditues të dytë

Gjatë periudhës Janar-Prill 2024, në KLSH:

- janë rekrutuar 11 punonjës të rinj sipas procedurave të ligjit të nëpunësit civil dhe 6 punonjës referuar përcaktimeve të Kodit të Punës; si dhe
- kanë ndërprerë marrëdhëniet administrative me KLSH-në, punonjës si rezultat i mbushjes së moshës për pension pleqërie, pezullim statusi për shkak të angazhimeve jashtë institucionit (projekte, kualifikime, shëndetësore), dorëheqje, etj.

Infografik nr. 9: Organizimi i Burimeve Njerëzore



5.2 Trajnimet


Gjatë periudhës janar - prill 2024, u realizuan 79 tema trajnimesh, nga të cilat 27 organizuar nga ASPA & partnerë lokal dhe 52 nga KLSH & partnerë ndërkombëtarë si EUROSAT, IDI, CEF, SAI-e homologe, etj. U trajnuan gjithsej 160 auditues, duke realizuar mesatarisht 8 dite trajnimi/auditues për periudhën 4 mujore (nga 6 -8 ditë trajnimi që është objektivi 4 mujor). Ndërsa janë realizuar trajnime për 35 punonjës, staf jo-auditues, duke realizuar mesatarisht 3.4 ditë trajnimi/punonjës, në 4 muaj**.

Gjatë këtij viti rreth 62% e trajnimeve u realizuan në sallë, me prezencë fizike, ndërsa 38% e tyre on-line.

Ndër temat kryesore objekt trajnimi gjatë 4 muorit të parë të vitit 2024, rendisim:

- tema që prekin çështjet mjedisore (si industria nxjerrëse, burimet ujore),
- tema mbi çështje të integritetit,
- forcimi i kapaciteteve audituese për auditimin e koncesioneve/PPP-ve,
- siguria e informacionit dhe krimi kibernetik dhe përmirësimi i aksesit me standarde të larta në shërbimet publike nëpërmjet GovTech.,
- të shkruarit e raporteve,
- menaxhimi i cilësisë së auditimit,
- metodologjia e auditimit dhe manualët e auditimit

Infografik nr. 10: Ditët e trajnimeve për stafin auditues dhe jo-auditues, Janar-Prill 2024



*Objektivat vjetore për realizimin e diteve të trajnimit për stafin auditues dhe jo-auditues për vitin 2024, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 22, datë 05.02.2024 "për miratimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Stafit të KLSH-së, për vitin 2024".

6. PROGRAMI I TRANSPARENCËS DHE E DREJTA PËR INFORMIM


Kontrrolli i Lartë i Shtetit vijon të shqyrtojë me korrektësi dhe profesionalizëm të gjitha ankesat, denoncimet dhe kërkesat për informacion të ardhura nga qytetarët dhe media të ndryshme. Konkretisht, gjatë periudhës janar - prill 2024, ka administruar 104 letra nga qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit në formën e ankesave apo denoncimeve.

Numri më i madh i këtyre ankesave ka marrë një përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Një pjesë e tyre mbeten në proces verifikimi në auditime të radhës sipas tematikave përkatëse, në përfundim të të cilave KLSH informon menjëherë qytetarin.

Ndërkohë, ankesa të vlerësuara jashtë fushës së kompetencave të KLSH-së, i janë dërguar për kompetencë institucioneve përgjegjëse ose është orientuar qytetari nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet t'i drejtohet, për të marrë përgjigje lidhur me problematikën që trajton.

Gjithashtu, në bazë të ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", Kontrrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar-prill 2024, ka trajtuar 17 kërkesa për informacion të ardhura nga qytetarë, deputetë dhe përfaqësues të medias. Këto kërkesa kanë qenë kryesisht kërkesa mbi vënien në dispozicion të raporteve të ndryshme të auditimit të kryera nga KLSH dhe janë përcjellë tek kërkuuesi brenda afateve ligjore të përcaktuara,

Infografik nr. 11: Nr i ankesave, denoncimeve dhe kërkesave administruar në KLSH, janar - prill 2024



7. AUDITIME NË MEDIA



Veprimtaria audituese e KLSH-së vijon të ketë pasqyrim masiv si në median tradicionale, shtypin e shkruar dhe televizion, ashtu edhe në mediat online.

Gjatë periudhës janar-prill 2024, janë publikuar 143 artikuj në shtypin e shkruar, si dhe 411 artikuj e kronika televizive në median audio-vizive dhe online (nga të cilat, 60 janë kronika të transmetuara nga televizione të ndryshme), ku trajtohen gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga KLSH në subjektet e audituara.

Gjatë periudhës janar - prill 2024, vëmendje në media ka marrë *Raporti Vjetor i Performancës së KLSH 2023*, ku evidentohet dëmi ekonomik në buxhetin e shtetit për shkak të keqmenaxhimit të fondeve publike dhe shkelleve ligjore të kryera nga administrata shtetërore dhe vendore gjatë vitit 2023, si dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e situatës.

Bazuar në auditimet e KLSH-së, koncensionet në *sektorin e shëndetësisë*, si: dializa, sterilizimi i pajisjeve mjekësore, laboratorët, kontrolli mjekësor bazë, vijojnë të trajtohen intensivisht në media. Gjithashtu, me interes nga media është parë edhe auditimi i kryer në *Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza"*, gjatë vitit 2023, në të cilin, KLSH ka evidentuar se gjatë periudhës 2021-2022, pacientët ambulatorë që trajtohen për sëmundje tumorale, dializë dhe transplant nuk kanë marrë në kohë mjekimin, pasi ka pasur vonesa me furnizim për 13 barna.

Raporti i auditimit të performancës "*Kujdesi ndaj të moshuarve*", ku evidentohet se në institucionet e rezidenciale ka mungesa të mjekëve specialist për kryerjen e ekzaminimeve periodike, i është përcjellë publikut përmes medias me disa kronika televizive dhe artikuj.

8. ANEKSE

ANEKS 1: AUDITIMET SIPAS LLOJIT

Tabela 1: Misionet e auditimit në numër, sipas llojit

Lloji i auditimit	Nr.auditimesh	Pesha në %
Financiar	3	16%
Financiar & Përputhshmërie	11	58%
Performance	1	5%
Përputhshmëri	1	5%
Tematik (për çështje të veçanta)	3	16%
Total auditime	19	100%

Tabela 1.1: Misionet e auditimit në numër, sipas departamenteve

Departamenti i Auditimit	Nr.auditimesh	Temë auditimi	Total
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja	2		2
Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	5		5
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	11		11
Departamenti i Auditimit të Performancës dhe mjedisit	-	1	1
Total	18	1	19

Tabela 1.2: Auditimet sipas çdo departamenti

Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
1	1	Dega Doganore Kakavijë
Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
2	1	Agjencia e Prokurimit Publik
3	2	Prokuroria e Përgjithshme
4	3	Universiteti Politeknik të Tiranës
5	4	Gjykata Kushtetuese
Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
6	1	Bashkia Kamëz
7	2	Bashkia Vau i Dejës
8	3	Bashkia Durrës
9	4	Bashkia Krujë
10	5	Bashkia Lezhë
11	6	Bashkia Shkoder
12	7	Bashkia Këlcyrë
13	8	Bashkia Librazhd
14	9	Bashkia Korçë
15	10	Bashkia Maliq
16	11	Bashkia Fier
Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

17	1	Auditim Tematik: "Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Luecemi Limfoide Kronike (LLC), me barin "Ibrutinib 140 mg
18	2	Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2023
Nr	Nr	Departamenti i Auditimit të Performancës
19	1	Auditim Performance: "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës"

ANEKS 2: OPINIONET/MESAZHET/KONKLUZIONET E AUDITIMIT

Tabela 2: Opinioni/mesazhi/konkluzioni sipas llojit të auditimit

Lloji i auditimit	Lloji i opinionit		Të tjera		Pa opinion financiar	Total
	I modifikuar	I pamodifikuar	Konkluzion	Mesazh		
Financiar	1	2				3
I kombinuar						
- Financiar	6	3			2	11
- Përputhshmërie	10	1				11
Performance				1		1
Përputhshmërie	1					1
Tematik (<i>Tematik dhe Përputhshmërie për çështje të veçanta</i>)			3			3
Total	18	6	3	1	2	30

Tabela 2.1: Kualifikimi i Opinioneve sipas llojit të auditimit

Kualifikimi i Opinioneve sipas llojit të auditimit	Financiar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Mesazh	Pa opinion financiar	Total
Financiar	1	1		1				3
Financiar	1	1		1				3
I kombinuar		15	1	4			2	22
Financiar		6		3			2	11
Përputhshmërie		9	1	1				11
Performance						1		1
Performance						1		1
Përputhshmërie		1						1
Përputhshmërie		1						1
Tematik					3			3

Kualifikimi i Opinioneve sipas llojit të auditimit	Financiar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Mesazh	Pa opinion financiar	Total
Tematik (Tematik dhe Përputhshmërie për çështje të veçanta)					3			3
Total	1	17	1	5	3	1	2	30

Tabela 2.2 Kualifikimi i opinioneve sipas subjektit

Kualifikimi i opinioneve sipas subjektit	Financiar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Mesazh	Pa opinion financiar	Total
Financiar	1	1		1				3
Bashkia Vau i Dejës		1						1
Gjykata Kushtetuese				1				1
Prokuroria e Përgjithshme	1							1
I kombinuar		15	1	4			2	22
Financiar		6		3			2	11
Agjencia e Prokurimit Publik				1				1
Bashkia Durrës		1						1
Bashkia Fier		1						1
Bashkia Kamëz		1						1
Bashkia Këlcyrë				1				1
Bashkia Korçë		1						1
Bashkia Krujë							1	1
Bashkia Lezhë		1						1
Bashkia Librazhd							1	1
Bashkia Maliq		1						1
Bashkia Shkodër				1				1
Përputhshmërie		9	1	1				11
Agjencia e Prokurimit Publik				1				1
Bashkia Durrës		1						1
Bashkia Fier		1						1
Bashkia Kamëz		1						1
Bashkia Këlcyrë		1						1
Bashkia Korçë			1					1
Bashkia Krujë		1						1
Bashkia Lezhë		1						1
Bashkia Librazhd		1						1
Bashkia Maliq		1						1

Kualifikimi i opinioneve sipas subjektit	Financiar me theksim të çështjes	I kualifikuar	I kundërt	I pakualifikuar	Konkluzion	Mesazh	Pa opinion financiar	Total
Bashkia Shkodër		1						1
Performance						1		1
Barazia gjinore dhe fuqëzimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës						1		1
Përputhshmërie		1						1
Dega e Doganës Kakavijë		1						1
Tematik					3			3
Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Luecemi Limfoide Kronike (LLC), me barin “Ibrutinib 140 mg”					1			1
Universiteti Politeknik i Tiranës					1			1
Auditim Tematik: “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2023					1			1
Total	1	17	1	5	3	1	2	30

ANEKS 3: MASAT ORGANIZATIVE DHE PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

Tabela 3: Masat organizative dhe Propozime për përmirësime ligjore sipas subjekteve të audituara

Subjektet e audituara	Nr auditimesh	Masa organizative	Përmirësim ligjor	Gjithsej Masa
Institucione të qeverisjes qendrore dhe të vartësisë	6	60	3	63
Agjencia e Prokurimit Publik		11	3	14
Dega e Doganës Kakavijë		16		16
Gjykata Kushtetuese		10		10
Mbi disponibilitetin në treg dhe trajtimin në linjën e tretë të mjekimit të pacientëve të diagnostikuar me Luecemi Limfoide Kronike (LLC), me barin “Ibrutinib 140 mg”			6	6
Prokuroria e Përgjithshme		13		13
Universiteti Politeknik i Tiranë		4		4
Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	11	273		273
Bashkia Durrës		39		39

Bashkia Fier		32		32
Bashkia Kamëz		37		37
Bashkia Këlcyrë		27		27
Bashkia Korçë		28		28
Bashkia Krujë		10		10
Bashkia Lezhë		21		21
Bashkia Librazhd		14		14
Bashkia Maliq		27		27
Bashkia Shkodër		20		20
Bashkia Vau i Dejës		18		18
Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës	1	11		11
Barazia gjinore dhe fuqëzimi i grave nga zonal rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës	1	11		11
Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj	1			
Auditim Tematik: "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në 6/mujorin I-rë të vitit 2023	1			
Gjithsej Masa	19	344	3	347

ANEKS 4:EFEKTET NEGATIVE NË BUXHETIN E SHTETIT

Tabela 4: Vlera e efekteve negative, `000 lekë

Efektet negative	Dëm ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Mangësi (Tatime dhe Dogana)		Total Efekte financiare	Total Nr. Rekomandimi
	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr
Shpenzime	20,697	37	145,594	20			166,650	56
Të Ardhura	94	1	1,854,214	72	86,979	5	1,941,286	78
Total	20,790	37	2,000,168	92	86,979	5	2,107,937	134

Tabela 4.1 : Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas ndikimit në të ardhura dhe shpenzime, dhe subjektet ku janë konstatuar efektet `000 lekë

Efektet negative	Dem ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Total Nr. Rekomandimi	Total Efekte financiare
	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera
Shpenzime	36	20,697	20	145,954			56	166,650

Efektet negative	Dem ekonomik		Menaxhim joefektiv fondesh		Tatime dhe Dogana		Total Nr. Rekomandimi	Total Efekte financiare
	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera	Rek. nr	Vlera
Bashkia Durrës	7	1,795	3	42,348			10	44,143
Bashkia Fier	3	5,558	2	37,981			5	43,539
Bashkia Kamëz	8	2,456					8	2,456
Bashkia Korçë	4	1,527	7	49,459			11	50,986
Bashkia Krujë	3	1,310	3	12,635			6	13,945
Bashkia Lezhë	6	3,776	2	312			8	4,088
Bashkia Librazhd	2	363					2	363
Bashkia Maliq	2	250					2	250
Bashkia Shkodër	1	3,662	3	3,219			4	6,881
Të Ardhura	1		72	1,854,214	5	86,979	78	1,941,286
Bashkia Durrës			9	140,702			9	140,702
Bashkia Fier			5	282,582			5	282,582
Bashkia Kamëz			19	828,259			19	828,259
Bashkia Këlcyrë			2	19,379			2	19,379
Bashkia Korçë			8	191,442			8	191,442
Bashkia Krujë			7	198,022			7	198,022
Bashkia Lezhë			8	17,926			8	17,926
Bashkia Librazhd			4	39,084			4	39,084
Bashkia Maliq			4	53,273			4	53,273
Bashkia Vau i Dejës			6	83,545			6	83,545
Dega Doganore Kakavijë	1	94			5	86,979	6	87,073
Grand Total	37	20,790	92	2,000,168	5	86,979	134	2,107,937

Tabela 4.2 : Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas fushave kryesore `000 lekë

Efekte negative të grupuara sipas fushave kryesore	Dem ekonomik	Menaxhim joefektiv fondesh	Tatime dhe Dogana	Gjithsej
Shpenzime	20,697	145,954		166,650
Procedura prokurimi		64,328		64,328
Shpenzime operative		39,833		39,833
Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore		1,360		1,360
Shpenzime të tjera		40,433		40,433
Zbatim punimesh	20,697	-		20,697
Të Ardhura		1,854,214	86,979	1,941,286
Detyrime tatimore të vlerësuara			85,271	85,271
Penalitete të vlerësuara			1,708	1,708
Të Ardhura ne Urbanistike		153,243		153,243
Të Ardhura nga aktiviteti doganor	94			94
Të Ardhura nga qiratë/ shitje/blerje		67,428		67,428

Efekte negative të grupuara sipas fushave kryesore	Dem ekonomik	Menaxhim joefektiv fondesh	Tatime dhe Dogana	Gjithsej
Të Ardhura të Tjera		37,826		37,826
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale		1,595,716		1,595,716
Gjithsej	20,790	2,000,168	86,979	2,107,937

Tabela 4.3: Vlera e efekteve negative, të grupuara sipas fushave kryesore dhe subjektet ku është konstatuar efekti `000 lekë

Efekte negative të grupuara sipas fushave kryesore	Dem ekonomik	Menaxhim joefektiv fondesh	Tatime dhe Dogana	Gjithsej
Shpenzime	20,697	145,954		166,650
Procedura prokurimi		64,328		64,328
Bashkia Durrës		42,348		42,348
Bashkia Korçë		8,276		8,276
Bashkia Krujë		11,741		11,741
Bashkia Lezhë		312		312
Bashkia Shkodër		1,652		1,652
Shpenzime operative		39,833		39,833
Bashkia Fier		37,656		37,656
Bashkia Korçë		1,283		1,283
Bashkia Krujë		894		894
Shpenzime per paga, shperblime & sigurime shoqerore		1,360		1,360
Bashkia Fier		325		325
Bashkia Lezhë		0		0
Bashkia Shkodër		1,035		1,035
Shpenzime të Tjera		40,433		40,433
Bashkia Korçë		39,901		39,901
Bashkia Shkodër		532		532
Zbatim punimesh	20,697			20,697
Bashkia Durrës	1,795			1,795
Bashkia Fier	5,558			5,558
Bashkia Kamëz	2,456			2,456
Bashkia Korçë	1,527			1,527
Bashkia Krujë	1,310			1,310
Bashkia Lezhë	3,776			3,776
Bashkia Librazhd	363			363
Bashkia Maliq	250			250
Bashkia Shkodër	3,662			3,662
Të Ardhura	94	1,854,214	86,979	1,941,286
Detyrime tatimore të vlerësuara			85,271	85,271
Dega Doganore Kakavijë			85,271	85,271
Penalitete të vlerësuara			1,708	1,708
Dega Doganore Kakavijë			1,708	1,708
Të Ardhura ne Urbanistike		153,243		153,243
Bashkia Durrës		55,602		55,602
Bashkia Fier		6,063		6,063

Efekte negative të grupuara sipas fushave kryesore	Dem ekonomik	Menaxhim joefektiv fondesh	Tatime dhe Dogana	Gjithsej
Bashkia Kamëz		47,263		47,263
Bashkia Korçë		21,077		21,077
Bashkia Librazhd		9,049		9,049
Bashkia Vau i Dejës		14,189		14,189
Të Ardhura nga aktiviteti doganor	94			94
Dega Doganore Kakavijë	94			94
Të Ardhura nga qirate/ shitje/blerje		67,428		67,428
Bashkia Durrës		1,019		1,019
Bashkia Kamëz		36		36
Bashkia Korçë		57,918		57,918
Bashkia Lezhë		146		146
Bashkia Librazhd		2,206		2,206
Bashkia Vau i Dejës		6,103		6,103
Të Ardhura të Tjera		37,826		37,826
Bashkia Fier		6,700		6,700
Bashkia Kamëz		7,863		7,863
Bashkia Këlcyrë		10,200		10,200
Bashkia Korçë		2,127		2,127
Bashkia Krujë		4,317		4,317
Bashkia Lezhë		2,503		2,503
Bashkia Maliq		1,000		1,000
Bashkia Vau i Dejës		3,117		3,117
Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale		1,595,716		1,595,716
Bashkia Durrës		84,081		84,081
Bashkia Fier		269,819		269,819
Bashkia Kamëz		773,097		773,097
Bashkia Këlcyrë		9,179		9,179
Bashkia Korçë		110,321		110,321
Bashkia Krujë		193,705		193,705
Bashkia Lezhë		15,277		15,277
Bashkia Librazhd		27,829		27,829
Bashkia Maliq		52,273		52,273
Bashkia Vau i Dejës		60,136		60,136
Gjithsej	20,790	2,000,168	86,979	2,107,937

Tabela 4.4: Vlera e dëmit ekonomik sipas subjekteve dhe fushës ku është konstatuar, në `000 lekë

Subjektet e evaduara	Të Ardhura nga aktiviteti doganor	Zbatim punimesh	Gjithsej
Dega Doganore Kakavijë	94	-	94
Bashkia Durrës		1,795	1,795
Bashkia Fier		5,558	5,558
Bashkia Kamëz		2,456	2,456
Bashkia Korçë		1,527	1,527
Bashkia Krujë		1,310	1,310
Bashkia Lezhë		3,776	3,776
Bashkia Librazhd		363	363
Bashkia Maliq		250	250
Bashkia Shkodër		3,662	3,662
Gjithsej	94	20,697	20,790

Tabela 4.5: Vlera e menaxhimit jo efektiv të fondeve sipas subjekteve dhe fushës ku është konstatuar, në `000 lekë

Subjektet e evaduara	Procedura prokurimi	Shpenzime operative	Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	Shpenzime të Tjera	Të Ardhura në Urbanistikë	Të Ardhura nga qirate/ shitje/blerje	Të Ardhura të Tjera	Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	Gjithsej
Bashkia Durrës	42,348				55,602	1,019		84,081	183,050
Bashkia Fier		37,656	325		6,063		6,700	269,819	320,563
Bashkia Kamëz					47,263	36	7,863	773,097	828,259
Bashkia Këlcyrë							10,200	9,179	19,379
Bashkia Korçë	8,276	1,283		39,901	21,077	57,918	2,127	110,321	240,901
Bashkia Krujë	11,741	894					4,317	193,705	210,657
Bashkia Lezhë	312		0			146	2,503	15,277	18,239

Subjektet e evaduara	Procedura prokurimi	Shpenzime operative	Shpenzime për paga, shpërblime & sigurime shoqërore	Shpenzime të Tjera	Të Ardhura në Urbanistikë	Të Ardhura nga qirite/ shitje/blerje	Të Ardhura të Tjera	Të ardhurat nga sektori i tatimeve në qeverisjen lokale	Gjithsej
Bashkia Librazhd					9,049	2,206		27,829	39,084
Bashkia Maliq							1,000	52,273	53,273
Bashkia Shkodër	1,652		1,035	532					3,219
Bashkia Vau i Dejës					14,189	6,103	3,117	60,136	83,545
Gjithsej	64,328	39,833	1,360	40,433	153,243	67,428	37,826	1,595,716	2,000,168

Tabela 4.6: Vlera e mangësive në aktivitetin kontrollues tatimor/doganor me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore/doganore, në `000 lekë

Subjektet e evaduara	Detyrime tatimore të vlerësuara	Penalitete të vlerësuara	Gjithsej
Dega Doganore Kakavijë	85,271	1,708	86,979
Gjithsej	85,271	1,708	86,979

ANEKS 5: MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Tabela 5: Masa disiplinore sipas kuadrit ligjor përkatës

Lloji i masës	Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
Kompetencë të Titullarit	106	10	116
Largim nga shërbimi Civil	1		1
Për punonjës të larguar nga puna	12	3	15
Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet	8		8
Vërejtje e shkrim	38	4	42
Zgjidhje Kontratrës së Punës/Largim nga puna		2	2
Gjithsej	165	19	184

Tabela 5.1: Masa disiplinore dhe administrative sipas kuadrit ligjor përkatës

Lloji i masës	Masa Administrative	Masa Disiplinore	Gjithsej
Dënim me Gjobë	24		24
Kompetencë të Titullarit		116	116
Largim nga shërbimi Civil		1	1
Për punonjës të larguar nga puna		15	15
Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet		8	8
Vërejtje e shkrim		42	42
Zgjidhje Kontratrës së Punës/Largim nga puna		2	2
Gjithsej	24	184	208

Tabela 5.2: Masa disiplinore dhe administrative sipas llojit dhe subjektit

Lloji i masës/ Subjektet e audituara	Masa Administrative	Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
Dënim me Gjobë	24			24
Bashkia Fier	17			17
Bashkia Krujë	6			6
Gjykata Kushtetuese	1			1
Kompetencë të Titullarit		106	10	116
Bashkia Durrës		14		14
Bashkia Kamëz		35		35
Bashkia Këlcyrë			10	10
Bashkia Korçë		30		30

Lloji i masës/ Subjektet e audituara	Masa Administrative	Ligji nr. 152/2013 dt.30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" Neni 58, shkronjat (a,b,c ç)	Me Kodin e Punës dhe Kontratën Kolektive apo Individuale të Punës	Gjithsej
Bashkia Krujë		21		21
Bashkia Lezhë		1		1
Bashkia Librazhd		4		4
Dega e Doganës Kakavijë		1		1
Largim nga shërbimi Civil		1		1
Bashkia Korçë		1		1
Për punonjës të larguar nga puna		12	3	15
Bashkia Durrës		7		7
Bashkia Fier		3		3
Bashkia Këlcyrë			3	3
Bashkia Librazhd		2		2
Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pages për një periudhë deri në dy vjet		8		8
Bashkia Fier		1		1
Bashkia Korçë		7		7
Vërejtje e shkrim		38	4	42
Bashkia Durrës		19	4	23
Bashkia Fier		3		3
Bashkia Korçë		1		1
Bashkia Maliq		15		15
Zgjidhje Kontratrës së Punës/Largim nga puna			2	2
Bashkia Durrës			1	1
Bashkia Korçë			1	1
Gjithsej	24	165	19	208

Buletini Statistikor Janar – Prill 2024

Të dhënat statistikore janë raportuar nga departamentet e auditimit dhe janë përpunuar nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

Buletini Statistikor Janar - Prill 2024 është përgatitur nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional.

© Kontrolli i Lartë i Shtetit

Materiali i paraqitur në këtë dokument i nënshtrohet të drejtës së autorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Materiali mund të kopjohet ose riprodhohet vetëm për qëllime jokomerciale, përkatësisht riprodhim për kërkime, studime private ose për qarkullim të brendshëm të kufizuar brenda një organizate për qëllime studimore dhe analitike.

Kopjimi për qëllime jokomerciale duhet të shoqërohet me një njohje të mjaftueshme, të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst tjetër.



Rruga "Abdi
Toptani" Nr.1 Tiranë



klsh.org.al



+355 4 2247294



klsh@klsh.org.al